



FMN-ja arrin dakordim në nivel të stafit me Republikën e Kosovës për Marrëveshje *Stand-By* (SBA) dhe Instrumentin për Reziliencë dhe Qëndrueshmëri (RSF)

PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM

Mendimet e shprehura në këtë deklaratë janë të stafit të FMN dhe nuk paraqesin medoemos mendimet e Bordit Ekzekutiv të FMN. Stafi do të përgatitë një raport i cili, nëse merr aprovimin e menaxhmentit, do të prezantohet para Bordit Ekzekutiv të FMN-së për diskutim dhe vendimmarrje.

- Stafi i FMN-së dhe autoritetet e Kosovës kanë arritur dakordim në nivel të stafit për politikën ekonomike të Kosovës që do të mbështeten me Marrëveshje *Stand-By* me kohëzgjatje prej 24 muajsh (SBA) në vlerë prej rreth 100 milionë euro, dhe aranzhim në kuadër të Instrumentit të Reziliencës dhe Qëndrueshmërisë (RSF) prej rreth 78 milionë euro. Bordi Ekzekutiv i FMN-së do t'i shqyrtojë këto kërkesa gjatë javëve të ardhshme.
- Marrëveshja *Stand-By* pritet të jetë parandaluese dhe do të ofrojë likuiditet në rast se materializohen rreziqet negative, përfshirë ato si rrjedhojë e luftës së Rusisë në Ukrainë.
- RSF do të ofrojë financim të përballueshëm për të mbështetur angazhimin e Kosovës në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe masat e adaptimit, prodhimin më të gjelbër të energjisë elektrike dhe perspektivat afatgjata të rritjes, si dhe pritet të nxisë financim të mëtejshëm për klimën. RSF e Kosovës është e para në Evropë.

Uashington: Një mision i FMN-së i udhëhequr nga z. Gabriel Di Bella vizitoi Prishtinën gjatë periudhës 8-24 mars, si dhe gjatë periudhës 27 mars-14 prill mbajti takime virtuale dhe me prani fizike për të diskutuar mbi politikën makroekonomike, sektorin e energjisë, agjendën e reformave, politikën e zbutjes së ndryshimeve klimatike dhe adaptimit, si dhe mbështetjen e mundshme të FMN-së. Në përmbyllje të diskutimeve, z. Di Bella nxori këtë deklaratë:

“Kam kënaqësinë t’ju njoftoj se autoritetet e Kosovës dhe stafi i FMN-së kanë arritur marrëveshje në nivel stafi për t’i mbështetur politikën ekonomike të autoriteteve me një Marrëveshje parandaluese 24-mujore *Stand-By* me qasje në rreth 80 milionë SDR (rreth 100 milionë euro, 97 për qind e kuotës) dhe marrëveshje paralele RSF prej 62 milionë SDR (rreth 78 milionë euro, 75 për qind e kuotës). Marrëveshja në nivel stafi duhet paraprakisht të aprovohet nga Menaxhmenti i FMN-së dhe Bordi Ekzekutiv. Diskutimet e Bordit Ekzekutiv për këto marrëveshje priten të mbahen në fund të majit.

“Këto aranzhime të reja do t’i zbusin rreziqet negative dhe do t’i mbështesin përpjekjet e Kosovës për të fuqizuar kapacitetin e saj për ta ruajtur stabilitetin makroekonomik, për t’i mbyllur hendeqet e politikave dhe për të realizuar një rritje më të gjelbër.

“Pas rimëkëmbjes së fuqishme nga pandemia, rritja ngadalësoi ritmin e saj në vitin 2022 pas ngritjes së çmimeve të mallrave në nivel ndërkombëtar. Të dhënat preliminare tregojnë se BPV reale u rrit me 3.5 për qind në vitin 2022 gjersa inflacioni arriti nivelin prej më shumë se 11 për qind. Ndërsa çmimet e mallrave do të zbuten dhe politikën fiskale do të bëhen më mbështetëse, rritja parashikohet të jetë rreth 4-5 për qind në vitin 2023. Uljet e çmimeve të mallrave do të ofrojë lehtësira të nevojshme për ekonomitë familjare dhe biznese. Gjithashtu,

absorbimi më i fortë i programit të investimeve publike do të jetë shtytje shtesë e anës së kërkesës. Ngritja e moderuar e rritjes parashikohet ta mbyllë hendekun relativisht të vogël të prodhimit të Kosovës. Gjithashtu, çmimet më të buta të mallrave do të ulin inflacionin në 5 – 6 për qind në vitin 2023.

“Kundrejt kësaj pasigurie të lartë, rreziqet vazhdojnë të jenë kryesisht në rënie. Rritja e çmimeve të mallrave mund të çojë në rritje më të ulët dhe inflacion më të lartë, meqë Kosova është importuese neto e ushqimit dhe energjisë. Kushtet më të ashpra të financimit, përfshirë si pasojë e dështimeve të kohëve të fundit të bankave në SHBA dhe Evropë, mund të rëndojnë cilësinë e aseteve dhe likuiditetit të bankave. Programi i mbështetur nga FMN do t'i zbusë ndikimet negative në rast se materializohen këto rreziqe ose të tjera. Nga ana pozitive, realizimi më i fortë i investimeve publike mund të shtyjë një rritje më të lartë. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve është dëshmuar të jetë tejet rezilient dhe mund të befasojë sërish për të mirë.

“Ndërsa Kosova është duke i adresuar sfidat imediate, trajtimi i çështjeve strukturore dhe avancimi i tranzicionit të gjelbër mbetea nevoja kritike për të liruar një rritje më të lartë dhe më të gjelbër, për të rritur produktivitetin, si dhe për të tërhequr investime private. Elementet kryesore të marrëveshjeve përfshijnë si në vijim:

- *Qeverisja fiskale.* Programi do të mbështesë përpjekjet për të fuqizuar administratën tatimore, reduktuar informalitetin, përmirësuar analizën e rrezikut fiskal, përmirësuar menaxhimin e financave publike, si dhe për të forcuar më tej transparencën fiskale.
- *Stabiliteti Financiar.* Programi do t'i mbështesë përpjekjet për të forcuar pakon e politikave të BQK-së dhe qeverisjen e bazuar në rekomandimet e Rishikimit të Stabilitetit të Sektorit Financiar 2019 (FSSR).
- *Sfidat strukturore.* Programi do t'i mbështesë përpjekjet për mbylljen e hendeqeve në infrastrukturë dhe qeverisje, duke përfshirë përmes përditësimit të Vlerësimit të Menaxhimit të Investimeve Publike (PIMA) dhe fuqizimit të operacioneve të ndërmarrjeve publike.
- *Strategjia për energji dhe klimë.* RSF do t'i mbështesë përpjekjet për zbutje të ndryshimeve klimatike dhe adaptim, përfshirë ato të artikuluar në strategjinë e energjisë 2023-2032 të miratuar së fundmi. Konkretisht, programi do të mbështesë përpjekjet për të rritur përqindjen e burimeve të ripërtëritshme në prodhim të energjisë, ulur ndotjen, fuqizuar integrimin rajonal të energjisë, rritur eficiencën e energjisë, si dhe mbrojtur konsumatorët e cenueshëm të energjisë.

“Gjithashtu, marrëveshjet e reja pritet të nxisin mbështetje shtesë bilaterale dhe multilaterale dhe investime private në energji të gjelbër. Autoritetet shprehën synimin e tyre për të kërkuar plotësim të RSF-së pasi të identifikohen masat shtesë të reformës, duke përfshirë në kuadër të Climate-PIMA (C-PIMA) në vijim.”

“Gjatë vizitës së tij në Prishtinë, ekipi i FMN-së zhvilloi takime me zyrtarë të lartë të qeverisë, përfaqësues të sektorit privat, shoqërinë civile, si dhe partnerë zhvillimorë. Ekipi ynë shpreh falënderime për autoritetet të Kosovës për dialogun e sinqertë dhe konstruktiv dhe mikpritjen e ngrohtë, si dhe mirëpret angazhimin e vazhdueshëm në mbështetje të Kosovës dhe popullit të saj.”